

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

**Mbledhja nr. 7**

Prishtinë, më 25.02.2015, ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**Procesverbal**

**i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Jelena Bontic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë: z. Mahir Yagcilar – Ministër i Ministrisë së Administratës Publike, Fitim Sadiku, Agron Jashari, Fatos Mustafa, si dhe përfaqësues të OSBE-së, KDI-së dhe GAP.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 3. Sfidat nga raporti i progresit dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve që bien në fushëveprimtarinë e Ministrisë, i ftuar z. Mahir Yagcilar – Ministër i Ministrisë së Administratës Publike;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**

Procesverbalet u miratuan unanimisht pa vërejtje, por me kërkesën e znj. Alma Lama e cila kërkoi që nga procesverbali i fundit, pyetjet të adresohen tek bordi i RTK-së për përgjigje.

**Zenun Pajaziti** – miratoi, kërkesën e znj. Lama dhe kërkoj nga sekretaria që të gjitha pyetjet e anëtarëve të komisionit të adresohen tek bordit i RTK-së për përgjigje.

### **3. Sfidat nga raporti i progresit dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve që bien në fushëveprimtarinë e Ministrisë, i ftuar z. Mahir Yagcilar – Ministër i Ministrisë së Administratës Publike**

**Zenun Pajaziti** – duke iu drejtuar ministrit, tha se në bazë të kompetencave që komisioni ka, mbikëqyrjen e resorëve të Qeverisë, në planin e punës për muajin shkurt është paraparë takim me Ministrin e Ministrisë së Administratës Publike.

Ai, kërkoj nga ministri që të njoftojë komisionin për sfidat që dalin nga raporti i progresit si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve nga fusha e administratës publike.

Cilat janë sfidat kryesore për reformimin e administratës publike, e dyta, si ndikon reduktimi i buxhetit në E-qeverisjen dhe se a do të mund të arrihen objektivat për E-qeverisjen me këtë buxhet, apo duhet të bëhet rishikimi i buxhetit?

**Alma Lama** - Sa punëtorë ka administrata publike duke përfshirë edhe punonjësit me kontratë mbi vepër?

Sa paguan shteti i Kosovës qira për objektet e institucioneve dhe a keni ndonjë zgjidhje që ti shmangeni kostos së lartë?

Çfarë është bërë për reformën në administratën publike? A ka hartuar Ministria, Strategjinë për klasifikimin e vendeve të punës? Në bazë të cilave kritere është përzgjedhur kompania private e cila merret me informacionet dhe shërbimet elektronike në të gjitha institucionet e Kosovës?

**Pal Lekaj** - si rregullohet çështja e nëpunësve me kontratë mbi vepër, nga cila vijë buxhetore paguhen ata? Si vepron në komuna departamenti i inxhinieringut?

**Xhevahire Izmaku** - a do të sigurohet një objekt më i gjerë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil?

**Shqipe Pantina** - Cilat janë projektet që i ka zbatuar Agjencia për Shoqërinë Informative dhe çfarë planifikoni në të ardhmen?

Si ka ndodhur procesi dhe emërimi i sekretarëve permanent në Qeverinë e Kosovës? A ekziston regjistri i nëpunësve civil në regjistrin qendror? A janë nxjerrë aktet nënligjore që sugjerohen nga Raporti i Progresit që kanë të bëjnë me nivelizimin e pagave dhe gradimet? Cilat janë kriteret për punonjësit me kontratë mbi vepër në komuna dhe sa është numri i punonjësve që lejohet të pranohen me këtë kontratë? Sa persona janë ushtrues detyre brenda institucioneve të Kosovës?

Sa persona kanë përfutur nga fondi i kuadrove, cilat institucione dhe sa është vlera e fondit për vitin 2015?

Sa trajnime ka bërë IKAP dhe cili është mekanizimi që mat efektin dhe performancën e punonjësve që përfshihen në këto trajnime? Si bëhet vlerësimi i shërbyesve civil? Cilat janë masat ndëshkimore për keqpërdoruesit e makinave zyrtare? Cilët janë zyrtarët të cilët mund ta shfrytëzojnë makinën zyrtare pas orarit të punës? A do të bëhet një listë publike për makinat zyrtare? Pse do të shiten makinat zyrtare dhe cilat janë arsyet? A ka një çmim tavan që vendoset për zyrtarët e lartë?

**Zafir Berisha** - Kur do të përfundon reforma në administratën publike dhe cilës ministri i takon instituti meteorologjik? Sa punëtorë ka ky institut?

**Sadri Ferati** – pyeti lidhur me administratën publike, sfidat, reformimin, rekrutimin, në cilat raste lejohen nëpunësit me kontratë mbi vepër, dhe pse hyjnë punëtorët me kontratë mbivëpër në sistemin e pagesave? Sa zyrtarë janë larguar nga puna, të cilët nuk e kanë kthyer punëtorin në

punë pas vendimit të Këshillit të Pavarur? Pse nuk kthehen punëtorët në punë pas vendimit të Këshillit të Pavarur?

**Kujtim Paçaku** - Çfarë do të bëni për statusin e gjuhës rome në Prizren? Sa janë të sakta statistikat lidhur me romët në Kosovë?

**Mahir Yagcilar** – e njoftoi komisionin për të arriturat e Ministrisë së Administratës Publike dhe sfidat që dalin nga raporti i progresit për vitin 2014.

Ministria në kuadër të angazhimeve të saja për arritjen e objektivave për reformën e administratës publike dhe zbatimin e planit vjetor të punës, pas daljes së planit të progresit për vitin 2014, ka analizuar në hollësi dhe janë nxjerr sfidat dhe rekomandimet për realizimin e objektivave dhe aktiviteteve që dalin nga raporti në fjalë.

Reforma e administratës publike për vite me radhë ka qenë një ndër prioritetet e Qeverisë, proces i cili në mënyrë të vazhdueshme është prioritet.

Ministria ka për obligim të hartojë një strategji të re sa i përket reformës së administratës publike dhe ministria do të përqendrohet në avancimin e administratës publike që imponohet nga faktor të ndryshëm për shërbime më të mira të administratës publike. Strategjia do të bazohet në konkluzionet e raportit gjithëpërfshirës.

Në programin e Qeverisë, sipas analizave të dala nga monitorimi i zbatimit të reformës së administratës publike është konkluduar që nevojitet strategjia e re e administratës publike, e cila duhet të jetë e fokusuar në planifikime të zbatueshme të përcjella me burime të nevojshme financiare, etj

Prandaj, për strategjinë e ardhshme për reformën e administratës publike prioritet janë: korniza strategjike për reformën e administratës publike, rritja e përkushtimit e të gjithë mekanizmave përgjegjës për zbatimin e reformës së administratës publike, zhvillimi dhe koordinimi i politikave sa më adekuate, menaxhimi i burimeve njerëzore në administratë publike, një shërbim civil i strukturuar sipas standardeve për shërbim apolitik i bazuar në rekrutim të drejtë dhe transparent dhe promovim në bazë të meritës dhe ngritjes profesionale. Poashtu synohet për një sistem unik të pagave në administratë publike në bazë të një ligji i cili do të përfshin sistemin unik të pagave në sektorin publik, si çështje tjera me rëndësi janë digjitalizimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, llogaridhënia, e-qeverisja, menaxhimi i financave publike, është kërkesë e Komisionit Evropian që të gjitha shtetet që janë kandidatë për Bashkimin Evropian të kenë një standard në reformën e administratës publike duke krijuar kualitetin dhe eficiencën sipas parimeve të kodit të etikës. Ligji për pagat e nëpunësve civil nuk është duke u zbatuar në tërësi, janë në zbatim rregulloret për vlerësimet, gradime, të nxjerra nga ligji, por sa i përket pagës konkrete me përfundimin e klasifikimit të vendeve të punës dhe me një rishikim të buxhetit dhe me aktivizimin e sistemit të plotë të menaxhimit të burimeve njerëzore do të kalojmë në sistemin e ri të pagave, domethënë nga sistemi i unifikuar i pagave në një sistem të balancuar në të cilin do të përfshihen nëpunësit civil, sistemi shëndetësor, sistemi i arsimit etj, kjo nënkupton se do të kemi një ligj për të gjithë të punësuarit që paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Sa i përket ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë, ministria bënë monitorimin e anës teknike në kuptim të përdorimit të gjuhëve në webfaqe, përdorimi i gjuhëve dhe hapësira të ndryshme, ndërsa për monitorimin e ligjit është kompetent komisioni qeveritar për përdorimin e gjuhëve në Kosovë, gjithashtu edhe përdorimi i gjuhëve tradicionale në nivelin komunal nuk bie në kompetencë të MAP, rregullimi i kësaj çështjeje përcaktohet me kushtetutë, ligj dhe statutet e komunave.

**Zenun Pajaziti** - pyeti ministrin:

- Cilat janë sfidat kryesore të Ministrisë për të cilat mendoni se do të jenë më problematike sa i përket procesit të reformimit të administratës publike dhe

- a mendoni se mund të arrini objektivat për E-qeverisjen me një buxhet të reduktuar, a duhet të bëhet rishikimi i buxhetit.

**Mahir Yagcilar** - sfidë kryesore e qeverisë, për të gjitha institucionet, është zbatimi i reformës në administratën publike dhe kjo:

Ligji për shërbimin civil nuk është zbatuar në tërësi për arsye të mos përfundimit të katalogut për klasifikimin e vendeve të punës të cilin tani ministria e ka hartuar dhe në muajin prill do të përfundojmë me klasifikimin e vendeve të punës dhe pastaj do të plotësojmë të gjitha informatat në sistemin e burimeve njerëzore dhe ministria është e gatshme për zbatim, por për një implementim komplet nevojitet edhe zbatimi i ligjit për pagat e nëpunësve civil.

Numri i të punësuarve në institucione, nga radhët e komuniteteve, duhet të bëhet konform ligjit numri i të cilëve është përafërsisht 10%.

Sipas raportit të progresit, zbatimi i strategjisë për reformën e administratës publike është sfidë e madhe që ka rezultuar me rezultate të kufizuara, dhe me rekomandime për Qeverinë e Kosovës Ministria tani ka përfunduar punën finalizimi i riorganizimit në administratën publike përveç me disa agjencione.

Sa i përket mungesës së hapësirave për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, Ministria ka përkrah kërkesën e tyre për një objekt pune, por është vështirë që në territorin e komunës së Prishtinës të gjendet sipërfaqe për ndërtim të objektit.

Sa i përket e - qeverisjes, me reduktime buxhetore ka disa pengesa në implementim por shpresojmë që me një rishikim të buxhetit do të tejkalohen ato pengesa.

Në shërbimin civil janë 21.000 të punësuar, ndërsa ata që janë të punësuar me kontratë mbi vepër nuk kemi numër sepse ata nëpunës paguhën nga institucionet përkatëse, vija buxhetore mallra dhe shërbime, Ministria është duke përgatitur strategjinë, pesë vjeçare, për reformimin e administratës publike aktualisht jemi duke përgatit strategjinë për vitin 2015.

**Zenun Pajaziti** - në emër të komisionit shprehu gatishmërinë që të mbështet ministrinë çdo herë kur ministria konsideron që komisioni duhet të ngrit ndonjë çështje, si nga aspekti i plotësimit ndryshimit të ligjit apo raporti i progresit.

#### **4. Të ndryshme**

**Zenun Pajaziti** – i njoftoi anëtarët e komisionit se KDI, ka kërkuar që komisioni të identifikojë ligjet dhe çështjet për të cilat ka na plan të bëjë hulumtime dhe lidhur me këtë pyeti anëtarët e komisionit se a kanë ndonjë propozim dhe se propozimet e tyre mund ti adresojnë te zyra koordinuese e komisionit në mënyrë që pastaj të procedohen sipas rregullave.

Mbledhja përfundoi në ora: 14:45.

**Përgatitur nga :**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit  
Zenun Pajaziti**

---

